



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



Raport Përmbledhës

**MBI REALIZIMIN E STRATEGJISË
SË ZHVILLIMIT TË KLSH**

2018 - 2022

Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2018 - 2022, e miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 1353, datë 31.12.2017, pasuar nga Plani i Veprimit dhe Monitorimit (PVMS), miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së, nr. 1353/4, datë 24.04.2018, i rishikuar, përcaktoi 3 qëllime strategjike, 21 objektiva dhe 71 nën - objektiva, të cilat mbuluan dimensionet më të rëndësishme të zhvillimit të Institucionit, njëkohësisht në koherencë me objektivat e Planeve Strategjike 2017 - 2023 të EUROSAT-t dhe 2017 - 2022 të INTOSAI-t.

Konkretisht, qëllimet strategjike që shoqëruan aktivitetin e KLSH-së përgjatë kësaj periudhe 5 vjeçare janë:

Qëllimi 1

Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6 E-të.

Qëllimi 2

Optimizimi i kapaciteteve profesionale dhe aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve mbështetëse.

Qëllimi 3

Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit.

Nevoja për rishikimin e ligjit në drejtim të forcimit më tej të pavarësisë së KLSH

Qëllimi i parë strategjik, lidhet me rritjen e impaktit të punës audituese me fokus 6-E. Ky qëllim adreson çështje të një niveli të lartë siç është “Forcimi i pavarësisë dhe mandatit kushtetues të KLSH-së” apo përmirësimi i vazhdueshëm teknik dhe metodik i qasjes audituese.

Aktualisht, KLSH ka një ligj organik bashkëkohor, të hartuar më mbështetjen e ekspertizës së Bashkimit Evropian dhe të mbështetur në standardet e INTOSAI-t. Për një vlerësim më të plotë dhe koherent të nevojës për ndryshime, rishikimit të ligjit, në drejtim të forcimit të pavarësisë dhe mandatit të KLSH-së, është konsideruar të mbartet si një nën - objektiv për tu përmbushur në Strategjinë e Zhvillimit 2023 - 2027.

Përsa i përket *planit teknik dhe metodik të qasjes audituese*, KLSH ka vijuar të tregojë kujdesin e duhur në drejtim të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga SZHI 2018 - 2022 dhe prej rekomandimeve të lëna nga Komisioni Evropian dhe Kuvendi i Shqipërisë, duke hartuar dhe miratuar planet e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga këto institucione të rëndësishme.

Përmirësimi metodologjik gjatë kësaj periudhe 5 vjeçare, ka vijuar të mbështesë dhe nxisë ndryshimin e vazhdueshëm. Në funksion të realizimit të këtij objekti, vlen të përmendim:

Metodologji auditimi mbi bazë risku

Përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë së auditimit bazuar në analizën e riskut nëpërmjet:

- Rishikimit të vazhdueshëm të manualeve të auditimit, me qëllim reflektimin e ndryshimeve në ISSAI-të;
- Hartimit dhe miratimit të udhëzuesit të fushave me risk për auditimet e performancës (në vitin 2022);
- Udhëzuesi “ISAM”, i publikuar nga INTOSAI/IDI, mbi auditimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (në vitin 2022);
- Krijimit të Departamentit të Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional (në vitin 2021);

Thellimi në auditimet TI

Thellimin e auditimit të teknologjisë së informacionit nëpërmjet:

- Krijimit të Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (në vitin 2018), si një risi në fushën e auditimit veçanërisht në një kohë kur teknologjia po ecën me ritme të jashtëzakonshme;

**Fokus në rritje drejt
auditimeve të
performancës**

- Pasurimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të kuadrit metodologjik të punës audituese me dokumente të rëndësishëm si Manuali Aktiv i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Udhëzuesi për Vlerësimin dhe Matjen e Riskut (në vitin 2018);
- Përkthimin dhe publikimin e Dokumentit ISSAI/IFPP 5100 “Udhëzues mbi Auditimin e Sistemeve të Informacionit (në vitin 2021);

Rritje e vazhdueshme e numrit dhe cilësisë së auditimeve të performancës, nëpërmjet:

- Rishikimit të Manualit të Auditimit të Performancës (viti 2020 dhe 2021)
- Hartimit të “Udhëzuesit të përcaktimit të fushave me Risk, për auditimet e performancës” (viti 2022)
- Kryerjes së auditimeve paralele me SAI-e të tjera ku përmendim: (1) “*Ndotja e menjëhershme e deteve*” (viti 2019), me SAI-in e Kroacisë, Italisë, Sllovenisë, Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës; (2) “*Menaxhimi i mbetjeve plastike*” (viti 2021) me Gjykatën Evropiane të Llogarive, SAI-n e Bullgarisë, SAI-n e Republikës Çeke, SAI-n e Estonisë, SAI-n e Hungarisë, SAI-n e Maltës, SAI-n e Moldavisë, SAI-n e Portugalisë, SAI-n e Rumanisë, SAI-n e Serbisë, SAI-n e Sllovakisë dhe SAI-n e Holandës; (3) “*Të Drejtat e Pasagjerëve në Transportin Ajror*” (viti 2021) me SAI-et e rajonit të Ballkanit Perëndimor, nën mbikëqyrjen e SAI-t Suedez.

**Konsolidimi dhe forcimi i
mëtejshëm i sistemit të
menaxhimit të cilësisë**

Konsolidimin dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë, nëpërmjet:

- Hartimit dhe miratimit të Udhëzuesit të Menaxhimit të Cilësisë (2019);
- Krijimit të Drejtorisë së posaçme dedikuar për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e standardeve, në përbërje të së cilës janë auditues me përvojë të gjatë në auditim (2019)
- Rishikimin e Rregullores së Brendshme të KLSH-së (viti 2022);
- Finalizimin me sukses të Raportit të Vetëvlerësimit të Performancës, nën udhëheqjen e IDI dhe SAI-t të Norvegjisë (përfunduar në vitin 2022).

**Ndjekje periodike e
zbatimit të rekomandimeve**

Forcimin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nëpërmjet:

- Miratimit të Manualit për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve të auditimeve të KLSH-së dhe Regjistri elektronik institucional (2020);

Kontribut në luftën kundër korrupsionit

- Forcimit të bashkëpunimit me Kuvendin edhe nëpërmjet Platformës Ndërinstitucionale për ndjekjen e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga KLSH (periudha 2020-2022);
- Krijimin dhe përdorimin e sistemit të menaxhimit të auditimit e për menaxhimin dhe mbështetjen e proceseve në KLSH.

Sa i përket *kontributit në luftën kundër korrupsionit*, KLSH ka pasur një rol të vazhdueshëm proaktiv dhe produktiv nëpërmjet auditimeve, denoncimit të rasteve korruptive dhe shkëmbimit të informacionit në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Strukturën e Posaçme Anti Korrupsion (SPAK), Prokurorinë e Përgjithshme, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), etj.

Bashkëpunimi i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit ndjek një filozofi gjithëpërfshirëse, duke përkrahur, mbështetur dhe duke u angazhuar në çdo iniciativë ndër institucionale, brenda dhe jashtë vendit, për hartimin e dokumenteve strategjike përkatës. Gjatë vitit 2022, në partneritet me prezencën e OSBE-së në Tiranë, Autoriteti Italian Antikorrupsion (ANAC), ka zhvilluar dhe do të vijojë të zhvillojë një sërë sesionesh trajnimi për audituesit e KLSH, me synim forcimin e kapaciteteve profesionale në auditimin e PPP-ve dhe procedurat e prokurimit publik.

Në bazë të marrëveshjes së INTOSAI-t dhe Zyrës së OKB-së për Krimin dhe Drogën (UNODC), me synim zbatimin e bashkëpunimit ndërmjet SAI-t dhe institucioneve kundër korrupsionit, përfaqësuesit e KLSH-së kanë kontribuar në hartimin e udhëzuesit “Rritja e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit dhe organeve antikorrupsion në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit” miratuar në Kongresin XXIV të INCOSAI-t, nëntor 2022.

Së fundmi, KLSH është pjesë e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Sektoriale Kombëtare Antikorrupsion.

KLSH perceptohet si institucioni më efikas për llogaridhënie

Rritja e impaktit të punës audituese, në përmbushje të qëllimit të parë strategjik, *reflektohet edhe nga opinioni publik*, ku për të 5-in vit rradhazi KLSH perceptohet si institucioni më efikas për llogaridhënie. Sipas sondazhit të opinionit publik “Besimi në Qeverisje 2021”, kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), KLSH perceptohet si mekanizmi më efikas për llogaridhënie në vend (71.1%) e renditur e para në rradhë.


2. OPTIMIZIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE, AFTËSIVE AUDITUESE, PROCEDURAVE TË PUNËS, LOGJISTIKËS DHE FUNKSIONEVE TË TJERA MBËSHTETËSE

Gjatë periudhës 2018 - 2022, çdo auditues ka zhvilluar mesatarisht 27 ditë trajnimi në vit.

Qëllimi i dytë Strategjik, lidhet me "Optimizimin e kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse". Në përmbushje të këtij qëllimi, KLSH çdo vit ka miratuar Programin Vjetor të Zhvillimit të Integruar Profesional të KLSH-së, si një prej prioriteteve kryesore në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Për një konsolidim të vazhdueshëm dhe rritjen e efektivitetit të trajnimeve, është hartuar dokumenti "Rregullore mbi Zhvillimin e Trajnimeve të stafit të KLSH"¹ në vitin 2022.

Gjatë periudhës 2018 - 2022, çdo auditues ka zhvilluar mesatarisht 27 ditë trajnimi në vit.

Grafiku: Treguesi i ditëve të trajnimit për periudhën 2018-2022



¹ miratuar me Vendimin nr. 26, datë 08.02.2022.

Gamë e gjerë trajnimesh në përputhje me kërkesat e ISSAI-ve

Staf i kualifikuar në përgjigje të zhvillimeve të reja në fushën e auditimit publik.

Trajnimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional synon të:


- ✓ Sigurojë që audituesit të mbajnë dhe zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë, që ju nevojiten;
- ✓ Përmirësojë cilësinë e punës audituese, si dhe të ndihmojë audituesit të japin një kontribut domethënës në punë; i ndihmon, që të avancojnë në karrierë; si dhe u hap fusha të reja dijeje dhe njohurish në funksion të zhvillimit më tej të aftësive që kërkon auditimi publik.
- ✓ Ndikojë në hartimin e raporteve dhe rekomandimeve të kuptueshme për grupet e interesit, duke ndikuar ndjeshëm në rritjen e transparencës, mirëqeverisjen dhe përdorimin e parasë publike; duke nxitur rritjen e besimit të publikut tek KLSH; si dhe
- ✓ I jep një kuptim më të thellë konceptit të të qenit profesionist.

Gjatë periudhës 2018 - 2022 audituesit kanë marrë pjesë vazhdimisht, në aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare për forcimin e kapaciteteve audituese. Kështu, 22 auditues kanë përfunduar me sukses programet e internship-t në Gjykatën Evropiane të Llogarive (ECA) dhe 6 auditues kanë ndjekur programet e fellowship-it pranë Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO), si dhe të tjerë tashmë zotërojnë certifikata ndërkombëtare profesionale.

Temat e trajtuara kanë trajtuar çështje që lidhen me manuale dhe metodologji, në linjë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik, procedurat e prokurimeve, koncesioneve dhe PPP-ve, çështje që lidhen me infrastrukturën dixhitale, etikën, etj.

Në një linjë me objektivat e dokumentit të politikave të burimeve njerëzore si dhe me qëllim aftësimin profesional dhe metodologjik në funksion të përmirësimit të performancës, një pjesë e punonjësve kanë përfunduar studimet universitare në degë të dyta apo janë trajnuar dhe certifikuar brenda dhe jashtë vendit në përgjigje të zhvillimeve të reja në fushën e auditimit publik.

Grafiku: Tituj/certifikime të stafit auditues



Politika që sigurojnë barazi gjinore



KLSH, në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore i ka kushtuar vëmendjen e duhur respektimit të parimit të barazisë gjinore në të gjitha politikat, aspektet, veprimtaritë institucionale duke synuar eliminimin e fenomeneve të diskriminimit për shkak të gjinisë. Politika e KLSH-së në mbështetje të zhvillimit në karrierë të gjinisë femërore, reflektohet në numrin e konsiderueshëm që femrat zënë në nivele drejtuese, duke përfaqësuar 8 pozicione drejtuese kundrejt 14 drejtues në total.


3. FORCIMI I KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT

Bashkëpunimi me Kuvendin për rritjen e zbatueshmërisë së rekomandimeve

Në përmbushje të qëllimit të tretë strategjik, për forcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me Kuvendin dhe palët e interesit, KLSH hartoi Strategjinë e Komunikimit 2017 - 2019, e pasuar kjo nga Strategjia e Komunikimit 2022 - 2025, hartuar nën mbikëqyrjen e SIGMA-s (iniciativë e përbashkët e OECD dhe BE), si pjesë e domosdoshme për përmbushjen e misionit dhe objektivave strategjike të zhvillimit institucional, bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës, qartësisë, vërtetësisë, inovacionit, koherencës dhe aksesueshmërisë në informacion.

Gjithashtu, me synimin e institucionalizimit të marrëdhënieve të KLSH-së me Kuvendin e Shqipërisë, në kuadër edhe të rekomandimeve të BE-së, është miratuar Udhëzuesi për Institucionalizimin e Marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin, si dhe i është dërguar Kuvendit propozimi për ngritjen e një nën komisioni parlamentar pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, me qëllim forcimin e mekanizmave të kontrollit parlamentar në funksion të rritjes të zbatimit të rekomandimeve dhe rritjes së llogaridhënies së ekzekutivit. Në funksion të këtij objekti, KLSH ka vijuar të përditësojë me informacion platformën elektronike të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me rekomandimet e dhëna për institucionet qendrore dhe atyre të varësisë dhe statusin e zbatimit të tyre. Kuvendi është informuar periodikisht për rezultatet e punës audituese edhe nëpërmjet përcjelljes së buletineve statistikore periodike, raporteve periodike të zbatimit të rekomandimeve, raportit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit dhe raportit vjetor mbi performancën e KLSH-së.

Grafiku: Mbi popullimin e Platformës Ndërinstitucionale



Bashkëpunime të frytshme me komunitetin INTOSAI & EUROSAI

Angazhime të suksesshme në bashkëpunime për auditime paralele dhe hartime manualesh

KLSH, ka zhvilluar komunikimin me partnerët e jashtëm dhe të brendshëm, në ndjekje të praktikave më të mira, me qëllim rritjen e impaktit të punës audituese dhe optimizimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale, për t'iu përshtatur sa më mirë mjedisit në të cilin operon.

Komunikimi i KLSH-së, përgjatë periudhës 2018 - 2022, ka bashkëpunuar me palët e interesit, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve dhe aktiviteteve të përbashkëta.

Përgjatë gjithë periudhës 5 vjecare ka vijuar bashkëpunimi me insitucione dhe organizma të huaja, në zbatim të marrëveshjeve të lidhura, të cilat janë finalizuar me një sërë produkesh të rëndësishme për aktivitetin auditues si kryerja e auditimeve paralele apo prodhimi i dokumentave metodologjike, kyçe, për këtë aktivitet

Grafiku: Disa bashkëpunime të KLSH-së me institucione homologe

"Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë" / SAI Kroaci.

"Të drejtat e pasagjerëve në transportin ajror" / SAI-et e rajonit të Ballkanit Perëndimor udhëhequr nga SAI i Suedisë.

"Menaxhimin e mbetjeve plastike" / Me 11 SAI-e evropiane të udhëhequra nga SAI i Polonisë.

"Ndotja e menjëhershme e deteve" / SAI Kroaci

Hartimi manualit të Auditimit të Prokurimit Publik, i përgatitur nga ekspertë të Bankës Botërore në fushën e prokurimeve publike dhe përshtatur nga KLSH sipas kërkesave të institucionit.

Hartimi i Manualit të Auditimit të mashtrimit dhe Korrupsionit në kuadër të Projektit IPA.

**Pjesëmarrje në konferenca,
takime dhe grupe pune të
EUROSAI dhe INTOSAI**



**Bashkëpunimi me aktorë
të tjerë**

Duke i konsideruar këto organizata si partnerë të rëndësishëm, dhe përçues të vlefshëm të punës audituese të KLSH-së, mbi përdorimin e fondeve publike dhe që shërbejnë gjithashtu, si një ndihmesë për të identifikuar problematika të ndryshme të shoqërisë, KLSH ka vijuar komunikimin me to, duke marrë pjesë dhe duke kontribuar në panele diskutimi, takime dhe tryeza të rrumbullakëta.

Kështu gjatë periudhës 5 vjeçare të implementimit të Strategjisë së KLSH-së 2018-2022 përmendim marrëveshjet e bashkëpunimit me organizata si: "Qëndresa qytetare", "Organizata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri"; disa universitete si: "Aleksandër Moisiu", Durrës, Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër, Kolegji Universitar "LOGOS", Universiteti "Mesdhetar" i Shqipërisë, Albanian University; Agjencia e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm, SEDA, si dhe bashkëpunimi me Sekretariatit e Shtetit për Çështje Ekonomike, etj



Në përfundim, referuar Planit të Veprimit dhe Monitorimit të Strategjisë, për 3 qëllimet strategjike, nga **71** aktivitete/nën objektiva të SZHI-së për periudhën 2018-2022, **6** nën objektiva rezultuan të mos jenë realizuar plotësisht të cilat mbeten në proces realizimi.

Nga këto 6 nën-objektiva, realizimi i **4** prej tyre, kushtëzohet nga bashkëpunimi me institucione dhe organizma të tjera, konkretisht:

1. Nën objektivi (1.1.1) i cili ka në fokus miratimin e ndryshimeve në Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” i cili është mbartur si nën objektivi për tu realizuar edhe në Strategjinë 2023 - 2027; Realizimi i dy nën objektivave (2.4.5) “Hartimi i Programit dhe Kurrikulave për Certifikimin e Audituesve Publik” dhe (2.4.7) “Certifikimi i të gjithë audituesve të KLSH-së, si auditues të jashtëm publikë”, duke qenë në varësi të realizimit të nënobjektivit (1.1.1) për miratimin e ndryshimeve ligjore, nuk mundën të realizohen. Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim po vijon shqyrtimin e hollësishëm të të gjithë ndryshimeve ligjore të kërkuara, për vlerësimin e nevojave relevante për ndryshime në koherencë me ndryshimet e mjedisit dhe rrethanave.

2. Nën objektivi (1.3.3) “Përgatitja e Udhëzuesit Specifik për Auditimin e Zbatimit të Buxhetit” me asistencë të SIGMA/OECD” vijon të jetë në proces dhe grupi i punës i ngritur për këtë qëllim parashikon të finalizojë këtë udhëzues gjatë vitit 2023.

3. Nën objektivi (1.8.3) “Hartimi i Metodikës së përbashkët për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm. Me qëllim rritjen e zbatueshmërisë së masave të KLSH-së, është ngritur Sekretariati i Përbashkët për bashkëpunimin ndër institucional KLSH - MFE, por që nuk arriti të hartojë këtë manual. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2020, u finalizua “Manuali i Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve”, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 67, datë 23.06.2020, i cili tashmë shërben si një metodikë për këtë proces.

4. Nën objektivi (1.10.5) “Kryerja e Auditimit të Integritetit të nëpunësve publikë, bazuar në eksperiencat më të mira ndërkombëtare” nuk është realizuar plotësisht. Në funksion të realizimit të këtij nën objektivi, KLSH ka punuar për hartimin e bazës metodologjike dhe trajnimin e stafit në lidhje me vlerësimin e integritetit sipas metodologjisë së SAI-t të Hollandës, udhëhequr nga SAI Norvegjez, duke realizuar:

- ✓ IntoSaint “Manuali i Vetëvlerësimit të Integritetit të SAI-ve” (pjesë e botimeve të KLSH-së gjithashtu);
- ✓ EUROSAT “Forcimi i Infrastrukturës Etike në SAI dhe Auditimi i Etikës në Sektorin Publik”;
- ✓ Kodin e Etikës ISSAI 30/IFPP-130: “Auditimi i etikës në organizatat e sektorit publik, si të implementojmë ISSAI-30”², si dhe vazhdimisht punon për zhvillimin e kapaciteteve, nëpërmjet trajnimeve të stafit;
- ✓ Programet vjetore të trajnimit të stafit që përfshinë tema lidhur me menaxhimin e etikës dhe integritetit, mbi implementimin e detyrueshëm të rregullave të etikës, si dhe mbi ndërgjegjësimin dhe edukimin e punonjësve për ruajtjen e një profili me integritet të lartë;
- ✓ Pjesëmarrjen aktive të audituesve të KLSH-së në trajnimet e ofruara nga ASPA, me fokus çështjet e integritetit dhe etikës; si dhe
- ✓ Anëtarësimin e KLSH-së në Task Force-n e EUROSAT-t për Auditimin e Etikës, duke marrë pjesë në aktivitete ndërkombëtare mbi shpërndarjen e kulturës dhe integritetit në institucionet publike.

Strategjia e Zhvillimit 2018- 2022 udhëhoqi aktivitetin e Kontrollit të Lartë të Shtetit përgjatë periudhës 5 vjeçare. Ky dokument u monitorua me kujdesin e duhur, periodikisht, me qëllim vlerësimin e nivelit të arritjes së objektivave kundrejt parashikimit, mbështetur mbi Planin e Veprimit për zbatimin e saj.